

V E N D I M
Nr.327, datë 15.5.2003

**PËR KALIMIN E SISTEMIT TË PARABURGIMIT NË VARËSI TË MINISTRISË SË
DREJTËSISË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 12 të nenit 6 të ligjit nr.8678, datë 14.5.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”, të nenit 14 të ligjit nr.8553, datë 25.11.1999 “Për Policinë e Shtetit”, të nenit 15 të ligjit nr.8743, datë 22.2.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të nenit 29 të ligjit nr.8379, datë 29.7.1998 “Për hartimin dhe zbatimin e Buxhetit të Shtetit të Republikës së Shqipërisë” dhe të neneve 8 e 16 të ligjit nr.8983, datë 20.12.2002 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2003”, me propozimin e Ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Kalimi i sistemit të paraburgimit, së bashku me mjediset dhe pajisjet, nga administrimi i komisarivateve të Ministrisë së Rendit Publik në administrimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, në Ministrinë e Drejtësisë.

2. Numrit të përgjithshëm të punonjësve të Ministrisë së Rendit Publik t’i zbriten 322 punonjës.

3. Numrit të përgjithshëm të punonjësve të Ministrisë së Drejtësisë t’i shtohen 322 punonjës, të cilët do të shërbejnë në dhomat e paraburgimit.

4. Ministrisë së Rendit Publik, nga buxheti i miratuar për vitin 2003, t’i zbritet fondi prej 154 200 000 (njëqind e pesëdhjetë e katër milionë e dyqind mijë) lekësh, të ndara në zërat e mëposhtëm:

a) Paga 80 200 000 (tetëdhjetë milionë e dyqind mijë) lekë;

b) Sigurime shoqërore 22 000 000 (njëzet e dy milionë) lekë;

c) Shpenzime operative 52 000 000 (pesëdhjetë e dy milionë) lekë.

5. Ministrisë së Drejtësisë, në buxhetin e miratuar për vitin 2003, t’i shtohet ky fond, sipas zërave të caktuar në pikën 4 të këtij vendimi.

6. Marrja në dorëzim e mjediseve të paraburgimit të bëhet veçmas për çdo komisarariat. Ministri i Drejtësisë dhe Ministri i Rendit Publik të përcaktojnë radhën e marrjes në dorëzim, masat që do të merren dhe mënyrat e kryerjes së këtij dorëzimi.

7. Ministri i Drejtësisë dhe Ministri i Rendit Publik të përcaktojnë mënyrën e kryerjes së shërbimeve të nevojshme për funksionimin normal të paraburgimit, kur këto mjedise gjenden brenda hapësirave të komisarivateve.

8. Ngarkohet Ministria e Drejtësisë, Ministria e Rendit Publik dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi më 1 korrik 2003.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano